

Data: 12/08/2021 Ref.: 30M/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113(Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037(Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universiteti të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Fizioterapi, MSc ,120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
 - Edukimi në kujdesin shëndetësor, MSc, 120, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë që deri më 15 nëntor të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Fakulteti i Mjekësisë, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1	Fizioterapi, MSc ,120 ECTS	Harrije Hysenaj Merita Martinaj-Qorolli
2	Edukimi në kujdesin shëndetësor, MSc, 120	Arijana Kalaveshi Naim Jerliu Sanije Gashi

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar një vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Mjekësisë, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.


Vizitat janë organizuar më 08.03.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik, Mikus Dubickis dhe Wolfgang Patsch.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të Ekspertëve Ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Fizioterapi, MSc, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht dy (2) kapituj, substancialisht katër (4) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht një (1) kapitullë.
2. Për programin e studimit Edukimi në kujdesin shëndetësor, MSc, 120 - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht një (1) kapitull, substancialisht pesë (5) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht një (1) kapitullë.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 dhe 27 korrik 2021 kanë shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Mjekësisë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetit të Mjekësisë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.